

REKOMANDIME

1. Të hartohet një plan veprimi nga OJQ-të që veprojnë në komunën e Dragashit për të angazhuar ekspertë ligjor dhe social të cilët do të organizojnë takime të drejtpërdrejta me prindër të fëmijëve, në mënyrë që të vetëdijesohen për rëndësinë e arsimit të fëmijëve të tyre e në veçanti të vajzave të tyre;
2. Drejtoria komunale e Arsimit të merr masa paraprake që të siguroj transport dhe përkrahje financiare për të gjithë ato vajza të cilat nuk mund të ndjekin shkollimin për shkaqe financiare;
3. Çdo fundvit të organizohen kampanja informuese me klasat e nënta në të gjitha shkollat fillore të fshatrave të komunës së Dragashit ku nxënësve të këtyre klasave e në veçanti vajzave tu flitet për rëndësinë e vijimit të shkollimit të mesëm dhe avancimit të tyre profesional;
4. Institucionet lokale dhe qendrore të ndihmojnë dhe përkrahin shoqërinë civile e në veçanti shoqatat që merren me çështjet e barazisë gjinore në mënyrë që të kujdesen më shumë për integrimin dhe arsimimin e femrës në komunën e Dragashit.

**Edukimi nis 20 vjet
para lindjes!**

Shoqata për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore "THESARI" - Dragash

Sheshi I Dëshmorëve p.n.
Dragash, 22000

E-mail: ojqthesari@hotmail.com
Tel: +377 (0)44 244 900



Fushatë për ngritjen e vetëdijesimit për Arsimim të Femrave në Zonat rurale të Komunës së Dragashit

Projekt i financuar nga Agjencia për Barazi
Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të
Republikës së Kosovës




OJQ "THESARI"

Dragash

Nëntor 2012
Dragash

Të dhëna shqetësuese


Në bazë të të dhënave të siguruar nga Drejtoritë përkatëse të Arsimit në Dragash dhe Prizren, rezultojnë se në shkollat e mesme të këtyre dy komunave në vitin shkollor 2012-2013 janë regjistruar vetëm 81 femra ndërkohë që në vitin shkollor 2011-2012 klasën e nëntë e kanë kryer gjithsejtë 171 femra dhe 168 meshkuj. Nga kjo rezultojnë se më pak se gjysma e vajzave që e kanë përfunduar ciklin e mesëm të ulët, kanë vazhduar shkollimin e mesëm. Ky fakt është me të vërtetë shqetësues nëse krahasojmë numrin e femrave që kanë përfunduar klasën e nëntë në të gjitha shkollat fillore të komunës së Dragashit me numrin e femrave që janë regjistruar në shkollën e mesme.



Pas verifikimit dhe konstatimit të këtij fakti tepër shqetësues ekspertet tonë kanë punuar në hartimin e një pyetësori për të konstatuar realisht se cilët kanë qenë faktorët që kanë shtyrë vajzat që të mos vijnë arsimimin e mesëm. Anketuesit e angazhuar kanë kryer anketim në pjesën më të madhe të fshatrave të komunës së Dragashit. Në anketim janë përfshirë kryesisht vajzat të cilat nuk kanë vijuar shkollimin e mesëm apo edhe ato që kanë braktisur shkollën.

Përgjigjet në disa pyetje


Në pyetjen **Cila ka qenë arsyeja kryesore që ka bërë të mos vazhdoni shkollimin apo të ndërprisni atë?**, shumica e të anketuarave nga treva e Opojës e banuar me shqiptarë, janë përgjigjur 'Mos vullneti i prindërve'. Ndërsa tek pyetja e njëjtë që u është bërë vajzave nga treva e Gorës ku jeton minoriteti gorano-boshnjak, del se arsyeja kryesore që nuk kanë vazhduar shkollimin e mesëm apo të lartë është, 'Tradita dhe Zakoni'



Në pyetjen **Cili prind ka qenë kundër vazhimit të shkollimit tuaj?**, në trevën e Opojës 60 % e të anketuarave kanë deklaruar se nëna është kundër ndërsa 40 % kanë deklaruar se babai ishte kundër vazhimit të shkollimit të mesëm. Në të njëjtën pyetje, 56 % e të anketuarave në trevën e Gorës kanë deklaruar se nëna është kundër shkollimit të tyre, ndërsa 44 % tjerë thonë se babai.

Është interesant edhe fakti se thuajse gjithë të anketuarat e trevës së Opojës janë përgjigjur me 'PO' pyetjes se 'A do të vazhdonit shkollimin nëse do t'ju jepej mundësia tani duke eliminuar problemet që u'a kanë pamundësuar arsimimin tuaj', Nga të gjithë të anketuarat vetëm 4 % janë përgjigjur 'JO'. Pak më ndryshe del gjendja në trevën e Gorës, ku në pyetjen paraprake 60% janë përgjigjur me 'PO' ndërsa 40% me 'JO'

Nga kjo konstatohet se ekziston vullneti i përgjithshëm i vajzave që të avancohen në karrierën e tyre përmes shkollimit, por pengesë kanë qenë përgjithësisht prindërit e tyre e edhe kushtet jo të mira financiare.



KONSTATATIMET

Nga të dhënat e prezantuara del se me të vërtetë gjendja e arsimimit të femrës në komunën e Dragashit është në nivel jo të dëshiruar.

Konstatojmë se mbetet shumë punë për tu bërë, si nga institucionet lokale ashtu edhe nga OJQ-të dhe shoqëria civile që ta ngrënë këtë shqetësim dhe të merren më aktivisht me këtë çështje në mënyrë që në një të ardhme të afërt këta faktorë të cilët kanë ndikuar në mënyrë direkte apo indirekte për mosvijimin e arsimimit të femrës të eliminohen.

Ekspertet e angazhuar në përpilimin e pyetësorit dhe analizimin e rezultateve të pyetësorit kanë arritur në përfundim se për eliminimin e këtyre faktorëve negativ që kanë ndikuar në mosvijimin e shkollimit të femrës në komunën e Dragashit si dhe për ndërgjegjësimin e vajzave që të ndjekin sidomos shkollimin e mesëm të lartë, duhet të ndërmerren masa urgjente.